[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

c) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;

c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbyshjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kerkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Shtojca 6.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

BASHKELIDHUR SISTEMIT APP.

Malli duhet të jetë i shoqëruar me certifikatën e origjinës origjinale ose kopje të noterizuar.

Shënim: Për çdo standart ose emërtim marke të përmendur pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Artikulli	Përshkrimi	Sasia	Njësia	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Instalim matje online për 415 fiderat e N/Stacioneve	SIPAS FORMULARIT TË OFERTES		Drejtoria e Tensionit të Lartë OSSH SHA, Tiranë.	Brenda 16 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës

Afatet e lëvrimit: Brenda 16 (gjashtëmbëdhjetë) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2022-2023-2024 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në nenin 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", Ligjit Nr. 10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" (i ndryshuar). Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore:

"Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.2.2. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

Argumentimi:

Ligjvënësi në pikën 1 dhe pikën 2/a të nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, parashikuar për kufirin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohej në Procedurën e Hapur, ku përcaktohet; Pika 2/a: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore të kërkuar nga operatorët ekonomikë nuk mund të kalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e sipërm monetar; Referuar vlerës së fondit limit të kësaj procedure, AK ka menduar se vendosja e një vlere minimale të xhiros jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit* për të cilin operatori konkurron, është provë e mjaftueshme për të krijuar bindjen e Kontraktori i Autoritetit që operatorët ekonomikë ofertues të kenë kapacitetin ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën siç parashikohet nga AK.

Shënim: Meqenëse aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një diferencë për vlerën e xhiros që mund të pretendohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të justifikojnë vlerën e kërkuar të qarkullimit brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të nevojshme për paraqitjen e certifikimit të qarkullimit vjetor bazohet në nenin 43 të VKM 285/2021 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, ku thuhet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të qarkullimit vjetor të realizuar nga operatori ekonomik dhe, në rastin e xhiros së mbuluar nga kontrata, për një periudhë maksimale deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenin 13 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, i cili përcakton kushtet dhe afatet e paraqitjes së pasqyrave individuale të të ardhurave vjetore;

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të tarifave dhe taksave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 5, pika c në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitetet sipas të dhënave të QKB – së për vitin 2025 (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin e lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilin është regjistruar në QKB).

Argumentimi:

Kjo kërkesë është bazuar në nenin 76 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në përputhje me përcaktimet e ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar sipas të cilit operatorët ekonomikë duhet të shlyejnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në çdo adresë ku ushtrojnë aktivitet, në Ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, neni 40, në ligjin Nr. 131/2015 “Për QKB” i ndryshuar si dhe në Ligjin Nr. 9 723, datë 03.05.2007 “Për QKR”, i ndryshuar.

3. Kapaciteti teknik:

3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit të lotit që oferton, vlerë e cila është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë dhe është në përputhje me përcaktimet e LPP neni 40 pika 4:

“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij, për një periudhë të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e shpalljes së procedurës, jo më pak se 3 (tre) inxhinierë të profilit përkatës, nga të cilët:

- Të paktën 2 (dy) duhet të jenë Inxhinierë Elektrikë;
- 1 (një) duhet të jetë Inxhinier Elektronik, i cili duhet të jetë **i trajnuar dhe i certifikuar nga prodhuesi/distributori i matësve** që do të ofrohen/instalohen në kuadër të kësaj procedure.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion justifikues për përmbushjen e këtij kriteri, si më poshtë:

- Kontratat e punës ose dokumente të sigurimeve shoqërore që vërtetojnë përfshirjen në staf për periudhën përkatëse;
- Diplomën dhe/ose licencën profesionale për secilin inxhinier;
- Certifikatën e trajnimit të lëshuar nga prodhuesi/distributori i matësve për Inxhinierin Elektronik.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

- Kontratë pune të vlefshme;
- Diplomën e inxhinierëve;
- Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën tre muajt e fundit;

Argumentim:

Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar

Kërkesa për të patur inxhinieret e profilit elektrik, elektronik lidhet me faktin se e gjithë puna do të kryhet në nënstacionet elektrike me prani të tensionit dhe pajisjesh elektrike ndaj është e nevojshme të garantohet siguria në punë dhe instalimi sipas rregullave. Për shkak të specifikës dhe kompleksitetit që kanë këto pajisje “matesat online” këto do të shërbejnë për matjen në kohe reale të energjisë elektrike në 415 fiderat të nënstacioneve elektrike të shpërndarjes, dhe është e nevojshme që inxhinieri elektronik që do të mbikqyrë proceset e instalimit të jete të trajnuar nga prodhuesi i matesave që oferton.

Kjo kërkesë është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

Për Autoritetin Kontraktor, është dicka shumë e rëndësishme që ky numër i kërkuar të jetë pjesë e stafit të punësuar (periudha 3-mujore si periudhe minimale e parashikuar nga Kodi i punës), lidhur kjo me garancinë e eksperiencës teknike, kostot e trajnimeve dhe çertifikimeve, për të garantuar një cilësi dhe përgjegjësi të instalimeve të produkteve objekt prokurimi.

- 3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 2 (dy) punonjës të certifikuar për sigurinë teknike për punë ndaj elektricitetit, nga ISHTI (Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial) ose nga institucione ekuivalente me të.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

- Kontratë pune të vlefshme;
- Certifikata përkatëse;
- Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën 3 muajt e fundit;

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/b dhe 5/c dhe të nenit 44, të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 40, pika 5/b dhe 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ...”.

Bazuar tek legjislacioni në fuqi për prokurimet publike, kërkon të dëshmojë nga operatorët ekonomikë ofertues së pari, fuqinë punëtore të disponueshme dhe së dyti, zotërimin e

kapaciteteve profesionale në varësi të natyrës së specifikimeve teknike të kontratës objekt prokurimi.

Argumentim teknik për kërkesën: “Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 2 (dy) punonjës të certifikuar për sigurinë teknike për punë ndaj elektricitetit, nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të.”

Përmes kësaj procedure parashikohet jo vetëm furnizimi i matësve të energjisë elektrike me transmetim online të të dhënave, por edhe **instalimi dhe vënia në punë e tyre** në ambiente ku do të ndërhyhet direkt në pajisje dhe panele elektrike ekzistuese, të lidhura me rrjetin elektrik të shpërndarjes.

Ky proces kërkon **ndërhyrje elektrike aktive**, përfshirë:

- lidhjen e matësit në qarkun elektrik të tensionit të ulët (zakonisht 400 V),
- konfigurimin dhe testimin e funksionit të transmetimit online në kushte operative,
- zëvendësimin e matësve ekzistues dhe/ose ndërhyrje në lidhje sekondare në kabinete elektrike të vendosura në nënstacione ose poste të tensionit të ulët.

Këto punime mbartin **rrezik të drejtpërdrejtë për ekspozim ndaj rrymës elektrike**, prandaj kërkohet që personeli që kryen ato të jetë i **certifikuar për sigurinë teknike për punë ndaj elektricitetit**, sipas standardeve të përcaktuara nga **ISHTI** (Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial) ose nga institucione të njohura ndërkombëtare me standarde ekuivalente.

Përcaktimi i një **numri minimal prej 2 (dy) punonjësish të certifikuar** është bërë për këto arsye teknike:

- Instalimi i matësve në terren shpesh kërkon prezencën e **dy teknikëve**, për të respektuar masat e sigurisë gjatë ndërhyrjes në instalime ekzistuese.
- Sigurohet zëvendësimi i menjëhershëm i një tekniku në rast mungese, për të mos penguar zbatimin e kontratës.
- Operatorët ekonomikë me eksperiencë të mjaftueshme në fushën elektrike janë në gjendje të përmbushin këtë kërkesë minimale, e cila **nuk është diskriminuese**, por proporcionale me natyrën e aktivitetit që duhet kryer.

Në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, përfshirë:

- Ligjin nr. 10237, datë 18.2.2010 “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, i ndryshuar,
- Udhëzimin përkatës të ISHTI për certifikimin e punonjësve për punë në rrjete dhe pajisje elektrike,

kjo kërkesë është e justifikuar si një masë për të **garantuar zbatimin e sigurt të instalimit**, si dhe për të mbrojtur jetën e punonjësve dhe integritetin e pajisjeve elektrike.

3.4 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat **ose ekuivalentet e tyre**, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- a) Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH EN UNI **ISO 9001-2015 e perditesuar** (e vlefshme)/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH EN UNI **ISO 14001-2015 e perditesuar** (e vlefshme). /ose/ ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c) Certifikatën SSH EN UNI **ISO 45001:2018 e përditësuar**, (SSH EN UNI **ISO 45001 – 2023**) e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shendetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- d) Certifikatën SSH EN UNI **ISO 50001-2018, e përditësuar**, e vlefshme/ ose ekuivalent (Sistemi i Menaxhimit të Energjisë e vlefshme ose ekuivalent). Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.6 janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”,* si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij,

e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis të projektit si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 50001-2018 është një standard i ri i konceptuar për të asistuar kompanitë në zbatimin e një sistemi të menaxhimit të përshtatshëm për identifikimin dhe minimizimin e konsumit energjetik. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 50001:2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar (në rastin konkret realizimi i objekt prokurimi), të reduktojë kostot energjetike të kompanive, për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e një sistemi të menaxhimit të energjisë, qëllimi i të cilit është të mundësojë një organizatë që të ndjekë një qasje sistematike në arritjen e përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së energjisë, duke përfshirë efikasitetin e energjisë, përdorimin dhe konsumimin e energjisë dhe impaktet e tjera në mjedis.

3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi ose Distributori i Autorizuar për pajisjet dhe shërbimet që do të ofrojë.

- Matesat e energjise smart 1 dhe 5A;

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se paraqitet autorizim distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nëpërmjet një dokumenti zyrtar të vlefshëm (kontratë, certifikatë, deklaratë etj).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Ky kriter vendoset në përputhje me piken 6 dhe 8 të nenit 40 si dhe nenin 44 “Kërkesat e çilesise” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Sipas pikes 8 e nenit 40, pika 1 e nenit 44, e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. dhe në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

Autorizimi duhet të paraqitet pasi vërtetohet që prodhuesi autorizon Operatorin Ekonomik të tregtojë produktin e tij në Rajonin e Republikës së Shqipërisë. Me anë të këtij kriteri operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka të drejtat ligjore nga prodhuesi për të ofertuar mallin e kërkuar, origjinale të prodhuara nga prodhuesi. Në rast se ofertuesi e ka marrë të drejtën për të ofertuar mallin e kërkuar nga distributori i autorizuar atëherë, ofertuesi duhet të vërtetojë lidhjen midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Në shumicën e rasteve një Kompani prodhuese ka vetëm 1 Distributor ekskluziv brenda një shteti dhe për të vërtetuar që operatori që tenderon me kompaninë perkatese është distributor zyrtar dhe i Autorizuar kerkohet pikerisht letra e autorizimit.

Synimi i kësaj kërkesë për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit është garantimi që ofertuesi ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën me autoritetin kontraktor, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar mallra origjinale, me garanci e suport teknik.

3.6 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalogun/ët teknik për mallrat që do të furnizojë për këtë objekt prokurimi në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike. Në katalog, të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme mallrat e ofertuara, si edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DT. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike, me qëllim që AK të vlerësojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në DT.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 8, si dhe”, në bazë të nenit 45, pika 1 të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo kërkesë është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm Teknik dhe plotëson specifikimet e kërkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kërkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm. Në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të verifikojë që specifikimet teknike të paisjeve të propozuara nga operatorët ekonomik plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit , duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: certifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilesise ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara në Specifikimet teknike .

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet/shërbimet që parashikohen të realizohen në preventive si dhe për shkak të interesit të lartë që ka objekti

duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane. Prandaj e gjykojmë të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, që OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit.

Për të siguruar këtë gjë, por njëkohësisht dhe për të detyruar ofertuesit e mundshëm në zbatimin e këtyre standarteve ka parashikuar kërkesën e mësipërme vetëm për disa nga mallrat kryesorë me që do të përdoren në këtë objekt konkretisht OE duhet të japin dhe paraqesin në menyre të detajuara karakteristikat teknike të mallrave të përfshirë në dokumentat e tenderit, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga projektuesi.

Për këtë, ofertuesit duhet të deklarojnë produkte të pajisura me certifikatë konformiteti CE/certifikate cilesie etj. Me anë të venies në dispozicion në fazën e ofertimit dokumentat si autorizim-marreveshje angazhimi, skeda teknike, certifikata cilesie, certifikata konformiteti, raporte testimi ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë prodhim sipas kërkesave të projektit. Plotesimi i kërkesës sipas pikës 9, garanton Autoritetin Kontraktor për cilësinë dhe standartet e larta ndërkombetare dhe të perditesuara sipas teknologjise së re dhe bashkekohore.

3.7 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deklaratë konformiteti ku të shprehet që materialet të kenë markim CE/ose ekuivalentet e tyre.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në zbatim të: **Nenit 77, pika 1**, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, **“Për prokurimin publik”**, i cili përcakton se autoriteti kontraktor duhet të përshkruajë me saktësi objektin e kontratës dhe karakteristikat teknike të mallrave që prokurohen, duke përdorur **standarde dhe referenca objektive që sigurojnë konkurrencë të ndershme dhe vlerësim transparent** të ofertave;

Neni 40, pika 6, gërma (c), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”**, ku sanksionohet se autoritetet kontraktore kanë të drejtë të kërkojnë që operatorët ekonomikë të paraqesin **dokumentacion mbështetës që provon përputhshmërinë teknike të mallrave të ofruara me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, përfshirë certifikata të lëshuara nga institucione të njohura apo deklarata konformiteti.**

Kërkesa për **deklaratë konformiteti dhe markim CE** nuk është diskriminuese dhe është e ligjshme, pasi është një mënyrë standarde për të verifikuar se pajisjet dhe materialet që do të përdoren përmbushin kërkesat minimale të sigurisë dhe cilësisë të përcaktuara në legjislacionin teknik.

Markimi **CE (Conformité Européenne)** është një tregues që produkti është vlerësuar dhe përputhet me **direktivat dhe standardet teknike evropiane** të aplikueshme për sigurinë elektrike, elektromagnetizmin, materialet ndërtimore etj. Pajisjet dhe materialet që mbajnë këtë markim:

- Janë prodhuar në përputhje me **standarde teknike harmonizuese të BE-së** si p.sh. direktiva **Low Voltage Directive (LVD) 2014/35/EU**, **EMC Directive 2014/30/EU**, ose **RoHS 2011/65/EU**;
- I janë nënshtruar **testimeve zyrtare dhe vlerësimit të përputhshmërisë**, duke garantuar funksionim të sigurt dhe jetëgjatësi në mjedise teknike si nënstacione apo instalime elektrike;
- Sigurojnë **nivel të lartë mbrojtjeje për përdoruesin dhe ambientin**;
- Janë të identifikueshme dhe gjurmueshme përmes dokumentacionit teknik që e shoqëron deklaratën e konformitetit.

Prandaj, për të garantuar se **mallrat e ofruara janë brenda parametrave të kërkuar teknikë dhe përputhen me kërkesat e sigurisë**, është e domosdoshme që operatorët ekonomikë të paraqesin **deklaratën e konformitetit CE**, së bashku me dokumentacionin mbështetës, si dëshmi se produktet janë të certifikuara dhe të përshtatshme për përdorim në tregun evropian dhe vendas.

3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë testime zyrtare nga prodhuesi ose distributori i autorizuar (type test) për pajisjet/materialet e mëposhtme:

- Matesat e energjisë smart 1 dhe 5A;
- Panel për matje energjie për shumë matësa
- Kabëll i skermuar Cu, 4x4mm².

Argumentim: Kriteri i kërkuar në lidhje me testet tip ose rutine të produkteve të kërkuara nga prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kërkesa për paraqitjen e **testimeve zyrtare (type test)** për pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Matësat smart të energjisë elektrike 1 dhe 5 A
- Panel për matje energjie për shumë matësa
- Kabëll i skermuar Cu, 4x4mm².

bazohet në nevojën për të garantuar përputhshmërinë e këtyre pajisjeve me **standartet teknike ndërkombëtare dhe kombëtare**, si dhe sigurimin e **funksionimit të saktë, të besueshëm dhe të qëndrueshëm në kushte reale pune**.

1. Matësat smart të energjisë (1A dhe 5A):

Këto janë pajisje kritike për sistemin e matjes dhe faturimit të energjisë. Type test-et janë thelbësore për të provuar përputhshmërinë me standardet si:

- **IEC 62052-11, IEC 62053-21, IEC 62053-22, IEC 62053-23** për saktësinë e matjes;
- **IEC 62056** për komunikimin (DLMS/COSEM);
- **IEC 61000-4-x** për qëndrueshmëri elektromagnetike (EMC);
- **Testet e izolimit, temperaturës, lagështirës dhe tensioneve të tejkaluara**, që garantojnë jetëgjatësinë dhe sigurinë.

Pa type test, nuk mund të verifikohet nëse matësit i përmbushin këto kritere.

2. Panel per matje energjie per shume matesa:

Per panelet ku do te instalohen matesit e energjise elektrike eshte e rendesishme te jene te testuar dhe certifikuar sepse sic do panel tjetër që perdoren ne N.Stacionet elektrike, duhet te kete garancine, qendrueshmerine, jetegjatesine sepse do te instalohen pajisje elektrike qe jane nen tension. Duhet te jene rezistent ndaj kushteve atmosferike dhe ambjentit ku do te montohen.

Duhet te kene shkallen e mbrojtje IP sipas kushteve dhe standarteve IEC per keto pajisje, te kene jetegjatesi ne materialin e panelit dhe te jene te mbrojtur ndaj lageshtires.

3. Kabëll i skermuar Cu,4x4mm².

Edhe kablli i skermuar Cu 4x4mm², eshte e nevojshme te paraqiten testimet e kerkuara, sepse cilesia e tij si ne materialin e percjellesit Cu i cili duhet te kete shkallen e pastertise ashtu edhe ato izoluese prej PVC duhet te jene sipas standarteve IEC per keto pajisje.

Testimet jane kerkuar edhe per te qene rezistent ndaj parametrave elektrike, atyre te ambjentit por edhe per saktesine e procesit ku do te perdoren.

Përfundim: Paraqitja e testimeve zyrtare (type test) është **thelbësore për të verifikuar cilësinë, përputhshmërinë me standardet përkatëse dhe përshtatshmërinë për përdorim** të pajisjeve dhe materialeve të kërkuara në këtë procedurë. Kjo kërkesë është e justifikueshme teknikisht, sidomos duke pasur parasysh që këto pajisje janë pjesë e infrastrukturës kritike të matjes dhe menaxhimit të energjisë elektrike.

3.9 Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë për periudhën e garancisë së mallrave objekt prokurimi nga data e dorëzimit të mallit, sipas afatit të përcaktuar në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin e defekteve për shkak të prodhimit, instalimit dhe konfigurimit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli i lëvruar është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti që vjen nga prodhimi, instalimi apo konfigurimi të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimin ose riparimi i tyre pa pagesë nga operatori ekonomik.

3.10 Autoriteti/enti kontraktor kërko qe operatorët ekonomikë, ne ditën e hapjes se ofertave të dorëzojnë mostra të mallit (nga 1 cope), **”Mates Energjie Smart 3x230/400V, 3x57/100V, 1(10)A dhe 5(20)A”** dhe **”Modulin e komunikimit”** pasi e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat do të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe do të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e

prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

